

**AKTI I THEMELIMIT
TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MEMAJ CONSTRUCTION" sh.p.k**

Sot ne Tirane, me date 19.02.2024 **Z. /Znj.** Emanuel Memaj , atësia Ahmet, amësia Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Xhaferaj dhe banues në Xhaferraj, Topojan Kukes, me adresë Sahitaj; Nd. 5; H. 1; Ap. 0; Njësia Administrative Topojan; Kukes, lindur më 01/01/1987, gjendja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036144940 dhe nr. personal I70101139H , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, vendosi te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "**MEMAJ CONSTRUCTION**" sh.p.k mbeshtetur ne nenin 2, paragrafi "b", i Ligjit "Per sanksionet dhe mbrojtjen e prones private dhe nismes se lire te veprimtarise private, te pavarur dhe te privatizimit", ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ne te cilen eshte Ortaku i Vetem dhe per kete qellim harton Aktin e Themelimit te Tij, me permbajtjen si vijon:

**NENI 1
EMRI**

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet "**MEMAJ CONSTRUCTION**" sh.p.k e cila ketu e me poshte do te quhet "Shoqëria".

**NENI 2
FORMA**

Forma ligjore: Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar.

**NENI 3
BAZA JURIDIKE**

Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne përputhje me kete legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.

**NENI 4
SELIA**

Selia e shoqerise do te jete ne adresen: **Tirane Kamez, Kamez, Nd.9 H 1,1054 Rruga Gavris Dara** dhe mund te ndryshoje adresen e selise se saj vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**NENI 5
TERRITORI**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin ne territorin e Republikes se Shqipërisë si dhe jashtë saj. Shoqeria mund te krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne përputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

**NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Projektim, zbatim, implementimi dhe menaxhimi i projekteve te ndertimit te objekteve te ndryshme, ndertim i veprave te ndryshme, ndertesave, pallateve, etj. Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parasikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqëria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me keto leje nga organet kompetente.



**NENI 7
KOHEZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar kohore, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara me ligj ose me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 8
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 000 leke (njëqind mijë). Ky kapital është teresisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm. Shoqëria mund të shtojë ose të zvogëlojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve.

**NENI 9
KONTRIBUTET**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortakut të vetëm të Shoqërisë Z. **Emanuel Memaj**, me pjesëmarrje në masën 100% (njëqind përqind) në vlerën prej 100 000 leke (njëqind mijë).

**NENI 10
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë prej 1 (një) kote, plotësisht e shlyer, me vlerë nominale 100 000 leke (njëqind mijë).

**NENI 11
ADMINISTRIMI**

Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administratori shoqërisë është Z. **Emanuel Memaj** Ai do të ushtrojë këto detyra për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërteritje.

**NENI 12
DISPOZITA TË FUNDIT**

Shoqëria do të rregullohet nëpërmjet këtij Akti Themelues por edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i vetëm/ortaket dhe si i tillë do të miratohet në Qendren Kombëtare të Biznesit ditën e legalizimit si Person Juridik në Shqipëri.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtte ligjore.

THEMELUESI

EMANUEL MEMAJ
Emer, Mbiemer, Firme

